

Bade BAJRAMI

NDËRTIMET EMËRORE ME FOLJE BARTËSE

Me *ndërtime emërore me folje bartëse* apo, sipas terminologjisë frënge, *shprehje predikative me folje bartëse* dhe këtu po rimarrim përkufizimin e gjuhëtarëve frëngë¹ janë “shprehjet që përmbajnë një folje (folje bartëse) dhe një emër (emër predikativ) që përcillet ose jo me një përcaktues dhe merr ose jo një shtrirje”, të cilën këta gjuhëtarë e quajnë *modifikues*. Këto dy elemente formojnë një njësi sintaksore dhe semantike, i pari duke qenë vetëm një bartës, kurse i dyti përbën bërthamën e vërtetë predikative (kallëzuese) të shprehjes. Termin *predikat*² e marrim në kuptimin e tij logjik e semantik.

Për të qenë më të qartë dhe që të mos ketë asnjë dyshim, edhe pse emri predikat është bërthamë e ndërtimit, folja megjithatë është pjesë përbërëse e predikatit, sepse nuk ka predikat pa folje. Prandaj, nëse krahasojmë dy fjalitë vijuese:

1 *Leka ka frikë nga qeni i Mironit.*

2 *Ai ishte i zbehtë nga frika.*

Kuptohet vetvetiu se **kam frikë** në rastin e parë dhe **jam i zbehtë** në të dytin përbëjnë predikatin e fjalisë. Kur flasim për predikat, nënkuptojmë predikatin, bërthama e të cilit është një emër që përcillet patjetër me një folje

Në vitet e shtatëdhjeta gjuhëtarët frëngë³ përdorin të parët termin *bartës* dhe saktësisht *folje bartëse* për disa folje që Harris⁴ i quante *verbs*

¹ Mesli, N. 1989. Les locutions verbales dans les écrits de M. Luther. Doctorat nouveau régime, Aix-en-Provence

² kurse predikati (kallëzuesi gramatikor), citojmë këtu Gramatikën metodike të frëngjishtes „i përgjigjet përafërsisht realitetit sintaksor të grupit foljor,, , f. 128.

³ Gjuhëtarët e LADL (laborator i automatikës dokuëntare dhe gjuhësore)

⁴ 4 . Harris, Z. S. , shih The elementary transformations.

operators on nominalized verbs (folje vepruese mbi foljet e emëruara) sikur **have** te **have a look** , **make** te **make a trip**.

Mund të shtojmë këtu edhe një përkufizim, atë që jep *Grammaire méthodique du français*⁵ « (janë) foljet si **faire, donner, mettre**, etj. që krahas përdorimeve të tyre të zakonshme, mund të kombinohen me një emër, mbiemër, ose grup ndajfoljor për të ndërtuar një formë komplekse barasvlerëse me një folje ». Autorët e kësaj gramatike i quajnë gjithashtu *shenjues të predikativitetit* , term që tregon mirë se janë të gramatikalizuar.

Në gjuhën shqipe folje të tilla janë si **marr** (marr arratinë, marr vendim) ; **jap** (jap urdhër, jap fjalën, i jap fund, **vë** (vë bast), etj. që kombinohen me emra abstraktë për të formuar një ndërtim me vlerë të kallëzuesit. Me fjalë të tjera, folja bartëse mundëson aktualizimin, (vendosjen në kohë) *foljezimin* e emrit kallëzues. Pa dyshim se gramatikalizimi i saj nuk është aq i përkryer sa ai i foljeve ndihmëse, megjithatë një pjesë e këtyre foljeve kanë para së gjithash një funksion gramatikor.

Nëse folja bartëse aktualizon kallëzuesin emëror, ajo megjithatë sillet si folje, jo vetëm se do të bartë shenjat e kësaj kategorie të fjalës, por edhe do ta ruajë në të shumtën e rasteve ndërtimin, që ka si folje me kuptim të plotë leksikor. Megjithatë, është një fakt i pamohueshëm, derisa gjendemi në rrafshin e semantikës, se te **marr arratinë**, ideja e **arratisem** është te emri e jo te folja.

Një nga veçoritë e këtyre ndërtimeve është se ata parafrazojnë shpesh një folje të thjeshtë, gjë që tregon shembulli ynë te **marr arratinë** që ka përafërsisht të njëjtin kuptim me **arratisem**.

Pasi që struktura sipërfaqësore e ndërtimeve emërore është e ngjashme me atë të frazeologjizmave foljorë, ata ngatërrohen shpesh duke i radhitur në të njëjtën kategori me ndërtimet si : **marr vesh** dhe **marr vendim**. Mirëpo, klëtu është fjala për dy struktura plotësisht të ndryshme. Te **marr vesh**, tërësia e togfjalëshit ka një vlerë kallëzuesi dhe do të thotë **kuptoj**. Folja **marr** nuk ka aty plotës: s'mund të interpretohet **vesh** si kundrinë e saj. Asnjë nga veçoritë e zakonshme të kundrinës së drejtë nuk zbatohen këtu:

Leka **ka marrë vesh**

-përemërzimi *Leka e ka marrë

-formimi i fjalisë.lidhore: * vesh që ka marrë Leka

-Pyetje me *çka*: **Çka ka marrë Leka ? vesh* (pyetja dhe përgjigjja duken jo të natyrshme)

-Mundësia që të bëhet kundrinori kryefjalë në pësore: * *veshi është marrë nga Leka*

-Edhe përcaktimi është i ngurrosur:

**Leka ka marrë (*një, *këtë, *disa) vesh*

Nëse, përveç kësaj, vërejmë se kuptimi nuk është kompozicional pasi që as kuptimi i foljes **marr** as ai i emrit **vesh** e as shuma e tyre nuk mundësojnë të arrihet te kuptimi **kuptoj**, shohim se jemi në prani të një strukture të “ngjirë”, të një togfjalëshi të ngurrosur.

Struktura e brendshme e **marr vendim** është krejtësisht e ndryshme. Elementet mbajnë ndër vete marrëdhënie sintaksore të analizueshme. Vërejmë se emri **vendim** është një kallëzues emëror të cilin mund të vëmë në raport me kallëzuesin foljor **vendos**, sepse ai karakterizohet me të njëjtën fushë plotësish:

vendos (Leka , punoj)

vendim(Leka, punoj)

Ajo që i dallon këta dy kallëzues, nuk është as kuptimi, as natyra e plotësve të tyre, por statusi i tyre morfologjik dhe forma e aktualizimit të tyre: një kallëzues foljor aktualizohet me mbaresa të mirëfillta (zgjedhimi):

Leka (vendos, ka vendosur , do te vendosë) të punojë

Kurse kallëzuesi emëror aktualizohet me një folje bartëse, këtu **marr**:

Leka (merr, ka marrë, do të marrë) vendim të punojë .

Nocioni i foljes bartëse ka mundësuar përgjigjen pyetjeve të ndryshme lidhur me grupet emërore dhe me foljet: ky nocion raporton për shembull për dallimin e ndërtimit në mes kundrinës së një foljeje dhe atij të emrit morfologjikisht të lidhur me këtë folje. Kështu, grupi emëror:

Frika e Lenës prej qenëve lidhet me fjalinë bartëse

Lena ka frikë prej qenëve

dhe jo drejtëpërsëdrejti me foljen **frikësoj** .

Të marrim edhe një shembull tjetër, pasi që çështja është me rëndësi. Meqenëse struktura sipërfaqësore e **vë bast** dhe **vë re** është e njëjtë, ndodh që ato të asimilohen shpesh në të njëjtën kategori. Nëse kënaqemi me këtë analogji të shpejtë që bazohet në konstatimin se të dy sekuencat janë të përbëra me një folje me kuptim mjaft të përgjithshëm **vë** dhe me një emër (**bast, re**), atëherë ngatërrojmë dy lloje të ndërtimit mjaft

të ndryshëm siç do ta tregojmë. Të pranojmë fillimisht se të dy strukturat kanë disa karakteristika të përbashkëta :

-Ato përbëhen nga folja **vë** dhe një emër ;

-Ato kanë të përbashkët disa përcaktues si :

intensifikuesin **shpesh** : *Leka shpesh ka vënë (bast, re.*

krahasuesin : *Leka ka vënë (bast, re) më shumë se Petriti.*

Mirëpo dallimet duken menjëherë dhe ato janë më të rëndësishme.

Përcaktimi është më i ngurosur për **vë re** se për **vë bast**.

Përdorimi i pronorit është i pamundshëm :

*basti i tij / *re e tij.*

Shohim gjithashtu se **re** nuk mund të përbëjë një bërthamë të grupit emëror, siç është rasti i **bast**. Kjo pengesë e fundit vjen nga se formimi i lidhore është i ndaluar te **ve re** kurse është i mundshëm në **vë bast** :

basti që ka vënë Leka = basti i tij

** re që ka vënë Leka = * re e tij.*

Në **vë re** folja **vë** nuk mund të fshihet : **vë dhe re** shkojnë bashkë. Jemi pra në prani të një sere foljore **vë re**, që e konsiderojmë si një togfjalësh të ngurosur, me të vetmin dallim se përcaktimi i tij mund t'i nënshtrohet disa ndryshimeve: ai nuk është krejtësisht i ngurosur për arsye se mund t'i shtohen disa përcaktues.

Përkundrazi, ndërtimi **ve bast** është i përbërë nga kallëzuesi emëror **bast**, i aktualizuar nga folja bartëse **vë** që e "zgjedhon". Ky aktualizim mund të mos jetë i pranishëm në rastin e një grupi emëror, me fshirje të kësaj foljeje bartëse, pas formimit të lidhore :

Leka vë bast / basti që vë Leka / basti i Lekës / basti i tij

Ndërtimet me folje bartëse nuk janë pra togfjalësha të ngurosur Analogjia sipërfaqësore e **vë bast** dhe **vë re** është mashtruesë. Për të përcaktuar një ndërtim, duhet marrë parasysh tërësinë e vetive të tij . Analiza e propozuar që kundërvë **vë re** me **vë bast** vërtetohet nëse merren parasysh disa teste (bazohemi në testet e elaboruara nga S. Björkman). Dy ndërtimet vijuese kanë padyshim tipare të përbashkëta:

Leka merr arratinë / Leka merr vesh

-nuk ka pësore : **arratisja është marrë nga Leka / * veshi është marrë nga Leka*

Mirëpo dallimet janë shumë më të rëndësishme si:

- numri i ngulitur i emrit :

Leka merr një arrati , * disa arrati / Leka merr (*një , *disa) vesh*

- përdorimi i përemrit :

* *arratinë* , *Leka e ka marrë dje.* /* *vesh* , *Leka e ka marrë dje.*

- mungesa e bashkërenditjes : * *Leka ka marrë arratinë dhe vesh.*

- përemri lidhor:

Arratia që ka marrë Leka është e pabesueshme / * *Veshi që ka marrë Leka është i pabesueshëm.*

Analiza e shkurtër që u bë tregon se kur kallëzuesi emëror mund të funksionojë si emër kryesor i një grupi emëror, domethënë ta humbë aktualizimin e tij, shihet se emri ka plotës dhe jo tërësia folje + emër, siç duket me **jap fjalën** i dhënë shpesh si shembull i lokucionit foljor :

Leka jep fjalën e nderit

Leka jep fjalën e madhe të nderit.

Fjalën e madhe të nderit që jep Leka

Fjalën e nderit që jep Leka

Fjala e nderit e Lekës

Fjala e tij e nderit

Më në fund, disa lloje semantike të ndërtimeve emërore kanë bartës specifike, të përshtatshëm, shpesh me origjinë metaforike: **ushqej (një shpresë, një ndjenjë); lëshoj një britmë.**

Nga pikëpamja e kuptimit, do të mund të paramendonim një ngurosjë, sepse kuptimi i tyre nuk është drejtpërdrejt i pajtueshëm me emrat abstraktë që pasojnë. Mirëpo, nga pikëpamja sintaksore, sjellja e tyre nuk është e ndryshme nga ajo e foljeve bartëse të tjera që i pamë gjer më tani. Ato aktualizojnë kallëzuesit emëror që pasojnë, mund të zhduken pas përemrit lidhor, gjë që, (sipas përkufizimit) nuk mund ta bëjë një kallëzues

Ai ka ushqyer shpresën të niset.

Shpresën që të niset që ka ushqyer (gjatë). Shpresa e tij të niset.

Urrejtja që ushqen ndaj Lekës / Urrejtja e tij ndaj Lekës.

Britma e gëzimit që lëshon / britma e tij e gëzimit

Sikur bartësit e tjerë, ata s'mund të bëhen objekt i një emërzimi

**ushqimi i tij i shpresës / ushqimi i tij i urrejtjes / lëshimi i tij i britmës së gëzimit*

Gjendemi para një rasti të rrallë ku metafora nuk ndryshon vetitë e zakonshme të ndërtimeve të ngjashme .

Në fakt, ato që kemi emërtuar *ndërtime emërore me folje bartëse* i përgjigjet mjaft mirë asaj që leksikologjia e gjuhës shqipe i quan *bashkimet frazeologjike*. Analiza tregon se folja në këto ndërtime ia sjell

kallëzuesit emëror informatat e kohës dhe të aspektit; kështu që kjo folje nuk ka funksion kallëzuesor, ajo aktualizon kallëzuesin emëror. *Ndërtimet me folje bartëse* janë më tepër *ndërtime të gramatikalizuara sesa ndërtime idiomatike*. Ndërsa, strukturat e tjera F+ E të frazeologjizmave foljorë që nuk mund të pësojnë transformime mbi emrin, dëshmojnë për pandashmërinë e foljes nga emri, me fjalë tjera për ngurrosjen e tyre.

LITERATURA

1. Björkman S., le type „ avoir besoin“. Etude sur la coalescence verbo-nominale en français, Uppsala, 1978.
2. Giry-Schneider J., Les prédicats nominaux en français. Les phrases simples à verbes supports , Droz, Genève .
3. Gross M., Méthodes en syntaxe, Hermann, Papers in structural and Transformational Linguistics , f. 482-532, D. Reidel , Dordrecht, 1970.
4. Mesli N., 1989, Les locutions verbales dans les écrits de M. Luther, Doctorat nouveau régime, Aix-en-Provence .

NDËRTIMET EMËRORË ME FOLJE BARTËSE REZYME

Duke u mbështetur në punime të disa gjuhëtarëve perëndimorë mbi foljet bartëse, jemi përpjekur të sqarojmë dhe të zbatojmë këtë nocion në analizën e dallimit të ndërtimeve emërore me folje bartëse dhe njësive frazeologjike foljore me strukturë Folje + Emër të gjuhës shqipe.

Analiza ka të bëjë me struktura të llojit *marr vesh*, ku vihet në pah se *vesh* nuk mund të interpretohet si kundrinë e foljes *marr* dhe *marr vendim* që ka strukturë krejtisht të ndryshme sepse elementet mbajnë në mes vete marrëdhënie sintaksore të analizueshme. Ajo tregon se folja bartëse ia sjell një predikat (kallëzuesi) emëror informatat e kohës dhe aspektit, kështu që folja bartëse nuk ka funksion kallëzuesor; ajo aktualizon kallëzuesin emëror së bashku me përcaktuesit të cilët aktualizojnë plotësit. Ndërsa, strukturat F+ E, të njësive frazeologjike foljore nuk mund të pësojnë disa transformime mbi emrin, gjë që dëshmon për pandashmërinë e foljes dhe emrit, me fjalë tjera për ngurrosjen e tyre.